

VERBAL I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE JASHTEZAKONSHME
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " AGRIGOSE
SH P K, ME QENDER NE GOSE, RRETHI I KAVAJES, REPUBLIKA
E SHQIPERISE, ME KAPITAL SHOQEROR 86.400 LEKE,
PLOTESISHT TE DERDHUR.

Sot, me date 22 dhjetor 1993 ne oren 15,30, eshte mbledhur ne Gose Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme e ortakeve te shoqerise AGRIGOSE - SH.P.K. per te diskutuar dhe vendosur mbi kete rend dite

1 - Rritjen e kapitalit shoqeror me 89.243.000 qe i korrespondojne Lit.1.704.000.000., duke e rritur kapitalin aktual nga 86.400.000 leke ne 185.643.000 qe i korrespondojne 3.000.000.000 (tre miliard) lit.

2 - Modifikimi i neneve 5 dhe 10 te Statutit shoqeror.

Merr drejtimin ne baze te statutit Presidenti i Shoqerise, dok. Michele Cicella, i cili konstaton sa me poshte :

1) qe jane prezent te gjithë ortaket personalisht, dok. Michele Cicella, ne kualitatin e Administratorit te shoqerise VALERIA ITALIA S R L, posedues i 51840 kuotave te kapitalit shoqeror, per leke 51.840.000, te zotit Bajram Saraçi, ne kualitatin e perfaqsesit ligjor te N.B.GOSE, posedues i 34560 kuotave te kapitalit shoqeror, per leke 34.560.000., si dhe te gjithë Revizoreve efektive zoterinjve:
dok. Paolo Pacillo, z. Azem Kola, Dok. Maria Antonietta

2) qe ehste prezent dok. Flavia TOFFOLI, lindur ne Sesto al Reghena (PN) me 20/12/1943, si kujdestare, ne baze te aktit te noterit Marcello di Fabio te dates 26/10/1993, nr rep. 64907, dokument qe i bashkangjitet aktit prezent nen germen A - te Shoqerise SIMEST s.p.a., te vete Presidentit te Keshillit Administrativ, dok. Ruggero Manciatì, me qender ne Rome rruga A. Farnese n.4, me kapital shoqeror 209.509.533.000. e regjistruar ne zyren e tregetise prane Gjykates se Romes ne n. 6312/91 reg. soc. c.f. p. IVA 04102891001

Deklarohet qe Asamblea eshte rregullisht e mbledhur dhe qe mund te vendose ne menyre te vlefshme mbi Rendin e Dites, mbi pikat e te cilit te gjitha te pranishmit jane dakort dhe s'kundershtojne diskutimin. Thirrret te beje detyren e Sekretarit, per redaktimin e verbalit, ing Idrir Karkini dhe fillon zhvillimi i rendit te dites.

Presidenti thote qe shoqeria, me qellim qe tefurnizohet me ~~me~~ shume mjete fikuiduese (leke), qe mundesojne te zgjeroj aktivitetin, ka nder mend te rrise kapitalin shoqeror me ~~me~~ leke qe i korrespondojne 1.704.000.000. (nje miliard eshtaeqindekater milion), duke e rritur kapitalin aktual nga 86.400.000. leke ne *185.643.000* leke, baraz me 3.000.000.000. lit. Shton qe per kete arsye duhet te ndryshohen neni 5 dhe 10 i statutit, ne te cilin duhet te rezultojne si me poshte Hapen keshtu diskutimet. Asamblea degjon propozimin e Presidentit, mbi te cilin shprehhet ne favor edhe kryetari i Keshillit te Revizoreve, i cili deklaroi se kapitali shoqeror i shoqerise eshte plotesisht i derdhur. Pas diskutimeve te shkurtera me vote unanime

VENDOSJET

- a) te rrise kapitalin shoqeror me leke *29.243.000* qe i korrespondojne 1.704.000.000. lit duke i çuar 86.400.000 leket ne *185.643.000* leke, qe i korrespondojne 3000.000.000. lit
- b) per te aprovuar tekstin e ri te statutit, si me sipër the- ne nga Presidenti, duke modifikuar nenet 5 dhe 10 Neni 5 " Kapitali shoqeror i shoqerise eshte *185.643.000 leke* dhe eshte i ndare ne kuota ne baze te nenit 38 te ligjit 7638 te dates 19/11/92
- Neni 10 "Kapitali shoqeror i fiksuar ne leke *185.643.000 (nye qindet e kësaj shume)* sipas konferimenteve te ortakeve te ndare ne kuota, ne baze te ligjit, mund te rritet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se jash- tezakonshme te ortakeve. Shoqeria SIMEST s.p.a. do te kete lehtesine per ti dhene shoqerise VALERIA ITALIA kuotat e saja qe perfaqsojne 14 % te kapitalit

shoqeror brenda nje periudhe prej tete vjetesh,
me doreheqjen e ortakeve te tjere per te blere
keto kuota

Kapitali i nenshkruar keshtu ~~nenshkruhet~~-perritet
24.781.700 leke qe i korrespondojne 1.284 milion lit
nga shoqeria VALERIA ITALIA s.r.l.

Kapitali ne rritje nenshkruhet edhe nga shoqeria
SIMEST s.p.a. me leke 24.461.304 baraz me 420 milion
lireta

Kapitali i rritur qe esht nenshkruar, eshte nenshkruar dhe
derdhur ne kasen e shoqerise, me deklarate te Presidentit,
ne keto raporte:

1 Shoqeria VALERIA ITALIA s.r.l. ka derdhur ne kasen e
shoqerise nje shume qe i korrespondon 356 milion lit,
si dhe konferimente ne natyredhe eksperience prane AGRIGOSE,
per nje shume ne leke qe i korrespondojne 928 milion lireta
me nje kurs kembimi zyrtare ne momentin qe nenshkruhet
rritja e kapitalit shoqeror, nga te cilat 636 milion,
si konferiment ne natyre, siq rezulton nga garancia legale
e zotit Mario D'Amico, qe i bashkangjitet aktit
prezent nen germen C, dhe 292 milion lireta si
eksperience ,gje qe rezulton nga dokumentat,
te gjitha paisjet e persakruara ne garancin legale
benen prone e shoqerise AGRIGOSE S.p.A.

2. Shoqeria SIMEST s.p.a. do te derdhe brenda 8 (tete)
ditesh sipas ligjit ne kasat e shoqerise nje shume
lekesh baras me 420 milion lireta.

Ortaket nuk kane asnje lloj kundertshtimi mbi nenshkrimin
e bere nga shoqeria "SIMEST" s.p.a. sic eshte parashikuar
nga neni 10 i statutit, si dhe te drejten per blerjen
e metejshme brenda tete vjetesh, te kuotes se sho-
qerise SIMEST nga ana e shoqerise VALERIA ITALIA
Si rrjedhim i rritjes se kapitalit, siq u precizua
me siper, ortaket jane posedues te ketyre kuotave
1 - N.B.GOSE 32060.546 ^{leke} qe i korrespondojne 518.400.000
lireta baraz me 17,27 % te kapitalit shoqeror.
2- VALERIA ITALIA S R L 127.592.430 leke baraz
me 2.061.600.000. lit baraz me 68,73 % te kapitalit
shoqeror.

Fabrizio
Mario D'Amico
Azemi Kosta

Stavie

Mirko

3- SIMEST s. p. a . 25.990.024 ^{L.eks.} / qe i korrespondojne
420.000.000. lit, baraz me 14 % te kapitalit shoqeror
Aktit prezent i ngjitet nen germen B statuti i ri
qe permban ndryshimet e aprovuara.

Duke mos patur gje tjeter per te diskutuar, duke qene
deleguar per te ndryshuar statutin siç rezulton
nga verbali i kesaj Asambleje, dhe per ta kerkuar kete
ndryshim nga autoritetet kompetente ne qendren e
regjistrimit, e shperndan Asamblene duke qene se
ora eshte 17 00.

Akti eshte shkruar ne dy fleta me shirit te pafshishem
qe eshte lexuar dhe qe anetaret prezent e deklarojne
konform vullnetit te tyre, duke e aprovuar dhe nenshkruar

Stella Kulevskina

Bajram Serezo
Bej

Paolo Scell

Mario Antonio Casilli

Giuseppe

Aziz



PROCESVERBAL I MBLEDHJES
SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE

“AGRIGOSE” Shpk

Sot, me 19.05.2017, ora 9:00, u mbledh Asambleja e Pergjithshme e shoqerise “AGRIGOSE” Shpk, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar, te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit, me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS): J72902823F (ne vijim quajtur “Shoqeria”), ne baze te kerkeses se ortakut “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes” (ne vijim “MZHETTS”) te reflektuar ne procesverbalin e mbledhjes se dates 21.04.2017, me qellim shqyrtimin e ceshtjes si vijon:

RENDI I DITES

- Diskutim lidhur me privatizimin, transformimin ose ndryshimi i perqindjes se kuotave shteterore ne Shoqeri, ne vijim te deshires se ortakut “AMERICAN CAPITAL” Shpk per te kapitalizuar vleren e detyrimit financiar qe Shoqeria i ka ketij te fundit.

Merr kryesimin Z. Maksim Caslli, i cili konstaton se:

- (i) Asambleja e Pergjithshme eshte mbledhur rregullisht, ne perputhje me dispozitat ligjore dhe statutore ne fuqi;
- (ii) I pranishem ne mbledhje eshte ortaku “American Capital” Shpk, titullar i nje kuote qe i korrespondon 82,73% (tetedhjete e dy presje shtatedhjete e tre perqind) e kapitalit te Shoqerise.
Ortaku MZHETTS, titullar i nje kuote qe i korrespondon 17,27% (shtatembedhjete presje njezet e shtate perqind) te kapitalit te Shoqerise, nuk u paraqit ne mbledhje;
- (iii) Pjesemarrja ne mbledhje formon kuorumin e nevojshem per vendimarrje, ne perputhje me dispozitat ligjore dhe statutore ne fuqi.

Ne perputhje me sa me siper, Asambleja e Pergjithshme vendosi si me poshte vijon:

VENDIM

1. Miratimin e zmadhimit te kapitalit te Shoqerise me vleren 203,467,777 (dyqind e tre milione e katerqind e gjashtedhjet e shtate mije e shtateqind e shtatedhjete e shtate) leke, vlere e cila rezulton nga detyrimi financiar, pa interes, qe Shoqeria i ka ortakut American Capital Shpk. Kjo vlere eshte paraqitur ne Pasqyren e Pozicionit Financiar te dates 31.12.2016, ne zerin “Te tjera te

Pagueshme”, e percaktuar ne “*Shenime Shpjeguese 13*”. Vlera e re e kapitalit te Shoqerise behet 389,110,777 (treqind e tetedhete e nente milion e njeqind e dhjete mije e shtateqind e shtatedhete e shtate) Leke.

Sa me sipër, neni 5 i statutit te Shoqerise ndryshon si vijon:

“Neni 5. - Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali i shoqerise eshte 389,110,777 (treqind e tetedhete e nente milion e njeqind e dhjete mije e shtateqind e shtatedhete e shtate) Leke.

Pjesemarrja e ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- 1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Siper marrjes, titullar i nje kuote te llojit kontribut ne natyre, me vlere 32.060.000 (tridhete e dy milion e gjashtedhete mije) Leke, e cila i korrespondon 8,24% (tete presje njezet e kater perqind) te kapitalit te shoqerise.*
- 2. AMERICAN CAPITAL Shpk, titullar i nje kuote, te llojit kontribut ne natyre dhe para, me vlere 357,050,777 (treqind e pesedhete e shtate milione e pesedhete mije e shtateqind e shtatedhete e shtate) Leke, e cila i korrespondon 91,76% (nentedhete e nje presje shtatedhete e gjashte perqind) te kapitalit te shoqerise:*

Kapitali i shoqerise eshte i shlyer plotesisht.

Financimet e kryera nga ortaket e shoqerise ne baze te pjesemarrjes respektive ne kapital, nuk do te jene objekt i asnje lloj interesi.”;

2. Autorizimin e administratorit te Shoqerise per te nenshkruar statutin e saj te perditesuar.
3. Regjistrimin e ketij vendimi ne Regjistrin Tregtar, te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Per “AGRIGOSE” Shpk

“AMERICAN CAPITAL” Shpk

Maksim Casli

Maksim Casli

